

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË KOSOVË

Përmbledhje

E drejta e privatësisë dhe e drejta për informim janë të drejta themelore të njeriut në shoqërinë moderne. Në pjesën më të madhe të kohës këto dy të drejta janë të ndërvarura dhe e përplotësojnë njëra-tjetrën për t'u dhënë përgjegjësi institucioneve në raport me qytetarin.

Privatësia dhe liria e informimit burojnë nga Kushtetuta e Republikës e Kosovës dhe fuqizohen nëpërmjet Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Privatësia dhe e drejta e informimit shpesh përshkruhen si dy anët e të njëjtës monedhë që, në fakt, më shumë veprojnë si dy të drejta plotësuese që promovojnë të drejtat e individit për ta mbrojtur veten dhe për ta promovuar përgjegjshmërinë e institucioneve të shtetit.

Në ditët e sotme Agjencia për Informim dhe Privatësi numëron vetëm nëntëmbëdhjetë të punësuar, nëpërmjet punës të të cilëve qytetarët do të duhej të kishin pritje realiste që t'u garantoheshin këto dy të drejta.

Pas transformimit të këtij institucioni nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, mandati i saj është zgjeruar dhe autoriteti, si i tillë, është fuqizuar, duke pasur të drejtën tashmë të shqiptojë edhe gjopa për kontrolluesit e të dhënave, të sektorit publik e privat, në rast të shkeljeve ligjore si dhe ndaj institucioneve publike që tregohen mospërfillëse ndaj kërkesave të qytetarëve për t'u qasur në dokumente publike.

Në këtë punim paraqitet gjendja aktuale e respektimit të këtyre të drejtave dhe sfidat e autoritetit përkatës për t'u shërbyer qytetarëve me kapacitete të plota.

Fjalët çelës: *Privatësi, e dhënë personale, dokument publik, ndërvarësi*

Abstract

The right on privacy and freedom of information are both fundamental human rights in a modern society. These two rights are most of the time interdependent and complement one another to make institutions responsible in relation with citizens.

Privacy and freedom of information are sourced from the Constitution of the Republic of Kosova and are empowered through the Law on Personal Data Protection and the Law on Access to Public Documents.

Privacy and the right to be informed are often described being the two sides of the same coin, which act more like two complementary rights promoting the rights of individuals to protect themselves and to promote the responsibility of governmental institutions.

In the current situation while this academic paper is being drafted especially for this conference, the Information and Privacy Agency has managed to employ only nineteen people, through whose performance, citizens should have realistic expectations to have their rights guaranteed.

Upon its transformation from the National Agency for Personal Data Protection into the Information and Privacy Agency, its mandate became wider and the authority itself got empowered being given the mechanism of imposing fines to data controllers in both public and private sector in cases of law violations, as well as to public institutions neglecting citizens' requests to access public documents.

This paper drafted especially for this nation-wide conference represents the current situation to which extent are these rights respected and challenges of the respective authority to serve citizens with in full capacity.

HYRJE

E drejta e privatësisë, si një nga të drejtat themelore të njeriut, është përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës e Kosovës dhe fuqizohet përmes Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bazë të të cilit është themeluar autoriteti i pavarur për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji në sektorin publik dhe privat.

Mbrojtja e të dhënave është e lidhur drejtpërdrejt me besimin. Kur individi ka frikë që të tjerët nuk do t'ia respektojnë privatësinë apo nuk do të mund t'ia garantojnë sigurinë e të dhënave të tij, ai humbet besimin dhe nuk do që t'i ndajë të dhënat me të tjerët. Andaj, besimi është burimi kryesor i ekonomisë digjitale të cilin mund ta ndërtojë autoriteti i mandatuar me ligj që ta mbikëqyrë përpunimin e të dhënave të qytetarëve tanë.¹

Qasja në dokumente publike, si e drejtë qytetare, në radhë të parë, stimulon transparencën institucionale, por edhe zvogëlon aferat korruptive në sektorin publik, duke i bërë të qasshme për publikun të gjitha dokumentet që me ligj nuk janë paraparë të mbeten të mbyllura. Që të dyja ofrojnë qasje për individin në të dhëna personale që mbahen nga institucionet e shtetit, gjersa ligji që garanton privatësinë lejon qasje në të dhënat personale që mbahen nga sektori privat.

Është detyrë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi që ta kufizojë të drejtën e informimit kur ajo shkel të drejtën në privatësi dhe në mbrojtje të të dhënave personale. Qasja proaktive për të siguruar një balancë efektive duhet të jetë e përqendruar në krijimin e mekanizmave matës të dëmit eventual dhe të interesave të publikut në rast të refuzimit të qasjes.

Gjatë periudhës dhjetëvjeçare, që nga themelimi i autoritetit që kujdeset për respektimin e privatësisë së qytetarëve nga kontrolluesit e të dhënave personale nga sektori publik dhe privat, gjendja aktuale lë të kuptohet se duhet ende shumë punë për t'u bërë për krijimin e një besimi të qëndrueshëm nga qytetarët që të dhënat e tyre konsiderohen të sigurta. Vetëm një udhëheqje e depolitizuar e këtij autoriteti do të mund t'u bënte ballë sfidave serioze në këtë periudhë pandemie dhe do të mund ta kthente besimin e qëndrueshëm të qytetarëve në këtë autoritet të rëndësisë së veçantë.²

Në kuadër të këtij punimi do të ofrohet një vështrim historik mbi krijimin dhe zhvillimin ndër vite të autoritetit që kujdeset për mbrojtjen e privatësisë të qytetarëve dhe të garantimit të lirisë së informimit. Veç kësaj, brenda tij paraqitet gjendja aktuale e respektimit të këtyre të drejtave dhe sfidat e autoritetit përkatës, pavarësisht që autoriteti i mandatuar

¹ Jeton Arifi, nxjerrë nga intervista nga *Mirëmëngjesi Kosovë*, RTK, 2017

² Marrë nga editoriali me titull *Garantimi i privatësisë si mision qytetar*, botuar në portalin *2Lonline*, Kosovë, 2019

për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave që mbulon këtë fushë është themeluar vetëm dhjetë vjet më parë.

Vështrim historik mbi garantimin e privatësisë në Kosovë

Hapat e parë të shtetit të Kosovës për përkujdesjen e ligjshme të privatësisë së qytetarëve të vet i ka ndërmarrë me fuqizimin e ligjit përkatës gjatë vitit 2010 përmes të cilit ishte paraparë garantimi i të dhënave personale të secilit qytetar, në cilësinë e subjektit të të dhënave personale. Përmes fuqizimit të këtij ligji në qershor të vitit 2011 është themeluar autoriteti i pavarur i cili ka mbikëqyrur zbatimin e rregullave të përpunimit të të dhënave personale nga sektori publik dhe ai privat.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, siç është quajtur gjatë tetë vjetëve të para, deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri që rregullon këtë fushë, fillimisht është udhëhequr nga një organ kolegjal (Këshilli i Agjencisë), i përbërë prej pesë anëtarësh. Anëtarët e këtij këshilli njëkohësisht kanë shërbyer edhe si mbikëqyrës shtetërorë të cilët kanë pasur autorizime të zhvillimit të inspektimit ndaj kontrolluesve të të dhënave personale.³

Agjencia, pavarësisht prej vështirësive materiale teknike, kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe përvojës relativisht të vogël, në vitet e para të funksionimit të saj hapëroi bindshëm drejt operacionalizimit të plotë të saj për kryerjen e detyrave dhe obligimeve që buronin nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjatë mandatit të parë pesëvjeçar të këtij organi kolegjal ky autoritet arriti të anëtarësohej në shumë forume regjionale dhe ndërkombëtare të fushës që mbulonte, duke përfitur nga ekspertiza e autoriteteve homologe të cilat kishin përvojë më të madhe si kujdestare të privatësisë së qytetarëve të tyre.⁴ Për më tepër, gjatë kësaj periudhe kjo agjenci arriti të lidhte nëntë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet homologe të shteteve të regjionit dhe të Evropës e më gjerë, në saje të të cilave, ndërkohë, jetëson projekte bashkëveprimi, sidomos për trajnimin e personelit të saj në fusha të caktuara.

Për ta harmonizuar legjislacionin vendor me atë të Bashkimit Evropian, si dhe për t'i arritur standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale, Agjencia, në vitet e para të ekzistimit të saj, është mbështetur nga një projekt ekspertize TAIEX i Bashkimit Evropian, pastaj nga projekti i asistencës teknike IPA 1.⁵ Me qëllim të fuqizimit të këtij

³ Nataša Pirc-Musar, *Rekomandimet e mëtejme për zhvillimin e strukturës organizative të ASbMDbP-së*, 2015

⁴ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *Raport tjetor*, 2014

⁵ Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, *Raport për zgjedhës*, 2019

autoriteti të ri, mbështetje të kohëpaskohshme ka ofruar edhe Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë, i cili edhe aktualisht është duke vazhduar përkrahjen me ekspertizë në fushën e promovimit.

Aktivitetet promovuese të Agjencisë, të përqendruara kryesisht në vetëdijesimin e publikut dhe të ndërgjegjësimit të subjekteve kontrolluese, kanë mbetur mision i vazhdueshëm i këtij autoriteti që nga themelimi i saj.

Përparim vazhdimisht është shënuar në rritjen e numrit të dhënies së këshillave, opinioneve dhe komenteve rreth masave legjislative dhe administrative që kanë të bëjnë me përpunimin e të dhënave personale në institucionet publike dhe kompanitë e sektorit privat në nivel vendi.⁶

Sot ekziston një rrjet i zyrtarëve për mbrojtjen e të dhënave personale, nga një i tillë në çdo institucion publik dhe në kompanitë e mëdha të sektorit privat, të cilët, mes të tjerash, kanë rol ndërlidhës me Agjencinë e cila, ndër vite, ka investuar në këta zyrtarë me trajnime nga ekspertë vendorë dhe të huaj.

Ligji i ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁷, i cili ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2019, ka hapur rrugë për një qasje dhe mendësi të re të menaxhimit të këtij institucioni, duke i dhënë autorizimet vendimarrëse dhe menaxhuese të një individi, krahasuar me vitet e para kur i njëjti udhëhiqej nga një organ kolegial. Për më tepër, Agjencisë për Informim dhe Privatësi tashmë i është dhënë mekanizmi konkret i ndëshkimit të shkelësve të ligjit, i cili do të aplikohet nëpërmjet shqiptimit të gjobave⁸ në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo e fuqizon shumë ndikimin e autoritetit të pavarur dhe rrit efikasitetin e zbatimit të ligjit në praktikë.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative në përgjithësi, së këndejmi mediat elektronike, rrjetet sociale e deri tek individi si kontrollues i të dhënave në saje të platformës së gjerë digjitale, përbëjnë sfida për Agjencinë për Informim dhe Privatësi. Sfidat e kësaj natyre do të mund të tejkalohen më lehtë në saje të një bashkëpunimi e bashkëveprimi konkret me institucionet e tjera publike që ndërlidhen me këtë fushë.⁹

Fuqizimi i lirisë së informimit gjatë një dekade në Kosovë

Fillet e jetësimit në praktikë të së drejtës për t'u qasur në dokumentet publike në Kosovë datojnë njëmbëdhjetë vjet më parë, kur qe miratuar ligji i parë për qasje në dokumente publike.¹⁰

⁶ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *Raport vjetor*, 2015

⁷ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2019

⁸ Po aty, 2019

⁹ Jeton Arifi, drejtor, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 2017

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, 2007

Liria e informimit apo e drejta për qasje në dokumente publike deri para dy vjetësh është monitoruar nga një zyrë koordinuese pa mekanizëm konkret detyruës ndaj institucioneve publike, gjersa Institucioni i Avokatit të Popullit ka shërbyer si instancë e dytë, pa pasur mandat ekzekutiv për ta fuqizuar jetësimin e kësaj të drejte. Arsyet që e shtynë qeverinë t'ia kalojë këtë mandat Agjencisë për Informim dhe Privatësi lidheshin kryesisht me mandatin e saj ekzekutiv, respektivisht të drejtën ligjore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për të shqiptuar gjoha ndaj institucioneve publike të cilat do të tregoheshin mospërfillëse ndaj kërkesave të qytetarëve për t'u ofruar qasje në dokumentet publike që ato prodhojnë, mbajnë, ruajnë apo përpunojnë.

Nga korriku i vitit 2019, kur u miratua ligji i ri për qasje në dokumente publike, kjo e drejtë qytetare nuk konsiderohet më vetëm si një drejtë e paraparë me ligj, por si një obligim i ligjshëm i institucioneve publike. Mospërfillja e kësaj lirie të qytetarëve ndëshkohet nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.¹¹ Përgjegjës për ta zbatuar në praktikë këtë të drejtë, ligji i ka përcaktuar dy nivele brenda secilit institucion publik: zyrtarin kryesor administrativ dhe zyrtarin për qasje në dokumente publike.

Ky akt ligjor garanton të drejtën e secilit person, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike, të cilat nënkuptojnë çdo akt, fakt apo informatë të mbajtur nga institucioni publik.¹²

Duke qenë përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit të këtij ligji, Agjencia për Informim dhe Privatësi promovon dhe trajnon institucionet publike për ta zbatuar ligjin në praktikë. Mes të tjerash, Agjencia për Informim dhe Privatësi monitoron dhe raporton para Kuvendit rreth respektimit të këtij ligji nga institucionet e tjera publike, bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për organizimin e trajnimit të zyrtarëve të tyre, si dhe ndërmerr masa të parashikuara me ligj për zbatimin efektiv të kësaj të drejte.

Agjencia, gjithashtu, ka të drejtë ta iniciojë procedurën e deklasifikimit të dokumenteve të klasifikuara në rastet kur diçka e këtillë konsiderohet e domosdoshme për ta garantuar lirinë e informimit, por pa cenuar dispozitat e ligjit përkatës për klasifikimin e informacioneve.¹³

Institucionet publike kanë obligim që të raportojnë pranë Agjencisë një herë në vit lidhur me të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike që kanë pranuar gjatë vitit paraprak. Situata aktuale, për sa i përket respektimit të lirisë së informimit, mund të konsiderohet relativisht e kënaq-

¹¹ Gazeta Zyrtare 06/L-081, 2019

¹² Po aty, 2019

¹³ Jeton Arifi, marrë nga editoriali me titull *Hapërimi i kujdestarit të privatësisë*, botuar në portalin *2Lonline*, Kosovë, 2018

shme, sepse institucionet publike janë të vetëdijshme për ekzistimin e autoritetit mbikëqyrës.

Gjatë kësaj periudhe dyvjeçare Agjencia për Informim dhe Privatësi ka funksionuar kryesisht në fushën e këshillëdhënies për institucionet publike, zyrtarët e të cilave, duke njohur mandatin ekzekutiv të këtij autoriteti, shpesh nuk ndihen të sigurt se në cilat rrethana kanë të drejtë për ta rekuaruar qasjen e qytetarëve në dokumentet publike.

Përmbyllje

Si konkluzion, privatësia, si tërësi e të drejtave të individit për të pasur lirinë që të mos jetë i shqetësuar, ndikuar, përgjuar, mbikëqyruar në mënyrë të fshehtë etj., duhet parë si koncept më i gjerë sesa fusha e të dhënave personale e cila mbetet pjesë përbërëse e konceptit mbi privatësinë, por si këndvështrim është më i ngushtë, i përqendruar vetëm në të dhënat personale. Ndërkaq, qasja në dokumente publike, e cila ndryshe njihet edhe si liri e informimit, pavarësisht prej fuqizimit të ligjit përkatës nga viti 2010, vetëm në gjysmën e dytë të këtij viti do të fillojë të jetësohet plotësisht, pas emërimit të titullarit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, pavarësisht që ligji i ri që e mbikëqyrë këtë fushë ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2019.

Besimi i luhatur i qytetarëve për sigurinë e të dhënave të tyre personale dhe garantimin e lirisë së informimit është i lidhur ngushtë me paraqitjen e autoritetit të mandatuar për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të jetësimin të të drejtës për t'u qasur në dokumente publike, kredibiliteti i të cilit, në pesë vjetët e fundit, është dëmtuar dukshëm për shkak të mungesës të titullarit dhe pamundësisë së zhvillimit të inspektiveve.

Një vizion afatgjatë për kthimin e besimit të qytetarëve do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes aktuale të përpunimit të të dhënave personale nga sektori publik dhe nga ai privat, duke zbatuar në përpikëri dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, respektivisht duke respektuar në praktikë të drejtën në privatësi të çdo qytetari. Në anën tjetër, rifillimi i shqyrtimit të ankesave të qytetarëve, të cilët nuk kanë arritur të qasjen në dokumentet publike të kërkuara nëpër institucionet publike, nga Agjencia, si autoritet i apelimit, jo vetëm që rrit dhe fuqizon transparencën institucionale, por edhe ndikon pozitivisht në luftimin e korrupsionit në vend. Si kolektiv, them se po bëjmë punë të mirë. Adresimet e shpesh-ta të qytetarëve tanë në Agjenci më bëjnë të besoj se qytetarët nuk kanë qenë ndonjëherë më të vetëdijësuar rreth të drejtave të tyre në këtë segment, se çfarë mund të presin nga bizneset, organizatat apo institucionet publike të cilëve ata ua besojnë të dhënat e tyre.

Kemi shumë për të bërë ne si autoritet i mandatuar për ta mbikëqyrur jetësimin e këtyre të drejtave, duke vepruar bashkë me kontrolluesit e të dhënave nga sektori publik dhe privat, për të qenë në gjendje t'i kundërpërgjigjemi botës që po ndryshon me hapa të shpejtë.

Objektiv thelbësor i këtij institucioni mbetet ndërtimi i një kulture të besimit të të dhënave të sigurta në Kosovë, si dhe garantimi i jetësimin të të drejtës për të pasur qasje në dokumente publike. Ne do ta bëjmë pjesën tonë, duke këshilluar, edukuar, inspektuar e zbatuar. Sidoqoftë, këtë nuk e bëjmë dot të vetëm. Mbrojtja e të dhënave dhe fuqizimi i lirisë së informimit përfaqësojnë mision, jetësimi i të cilit kërkon punë ekipore. Rregullimi efektiv kërkon angazhim me sektorin publik, atë privat, shoqërinë civile dhe qytetarët në përgjithësi. E gjithë kjo ka të bëjë me qytetarët dhe rritjen e besimit të publikut rreth mënyrës se si po përpunohen të dhënat e tyre transparente. Nëse ia dalim t'i aplikojmë parimet që burojnë nga ligjet përkatëse, mund të arrijmë ta kthejmë besimin te qytetarët, sepse të drejtat e tyre janë të një rëndësie të veçantë për ta.

Referenca:

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *Anketë*. (2015). Nxjerrë nga rezultatet e anketimit të publikuar në: <http://www.amdp-rks.org/?page=1,10,182#.XfJOAzjsbWM>

Arifi, Jeton. (27.01.2019). Drejtor. Agjencia për Informim dhe Privatësi. Marrë nga editoriali me titull *Garantimi i privatësisë, si mision qytetar*, botuar në portalin '2Lonline', Kosovë.

Arifi, Jeton. (20.08.2019). Drejtor. Agjencia për Informim dhe Privatësi. Marrë nga editoriali me titull *Balancimi i të drejtës së informimit dhe privatësisë*, botuar në Portalin 'KosovaInfo', Kosovë.

Arifi, Jeton. (27.06.2018). Drejtor. Agjencia për Informim dhe Privatësi. Marrë nga editoriali me titull *Hapërimi i kujdestarit të privatësisë*, botuar në portalin '2Lonline', Kosovë.

Arifi, Jeton. (28.01.2017). Drejtor. Agjencia për Informim dhe Privatësi. Marrë nga editoriali me titull *Privatësia nga një e drejtë, në traditë*, shënjimi i 28 Janarit - Ditës Ndërkombëtare të Privatësisë në Kosovë, botuar në gazetën 'Epoka e re'.

Arifi, Jeton. (28.01.2017). Drejtor, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nxjerrë nga intervista në "Mirëmëngjesi Kosovë", RTK: https://www.youtube.com/watch?v=bt_bpxN7umk

AShMDHP, (2014). *Raport vjetor*.

AShMDHP, (2015). *Raport vjetor*.

D., Warrem, D., Samuel, B., Louis. (1890), *The Right to Privacy*, Boston.

Faulkner, William. (1955). *Privacy, The American Dream: What Happened to it?*, Mississippi.

Gutwirth, Serge; Leenes, Ronald; De Hert, Paul; Poulet, Yves., 2012, *European Data Protection in Good Health?*, Springer, London.

Krasniqi, Jakup. (2011). *Vendim*, Prishtinë, Kuvendi i Kosovës.

Kuner, Christopher. (2007). *European Data Protection Law: Corporate Compliance and Regulation*. Oxford University Press.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). Kushtetuta.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 03/L-172, Gazeta Zyrtare. (2010). Prishtinë.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, 06/L-082, Gazeta Zyrtare. (2019). Prishtinë.

Ligji për Qasje në Dokumente Publike, 06/L-081, Gazeta Zyrtare. (2019). Prishtinë.

Njoftim për medime (2019). Nxjerrë nga Agjencia për Informim dhe Privatësi: <https://www.facebook.com/notes/agjencia-p%C3%ABr-informim-dhe-privat%C3%ABsi/njoftim-p%C3%ABr-medime/1740598952738731/>

Pirc-Musar, Nataša. (2015). *Rekomandimet e mëtejme për zhvillimin e strukturës organizative të AShMDhP-së*. Prishtinë, Kosovë, Hulla & Co. Human Dynamics KG (AU).

Raport i përzgjedhjes të fituesit të projektit të binjakëzimit në saje të IPA 2, EUOK, tetor 2019.

